



DREJTORIA E HARTIMIT DHE APLIKIMIT TE PROJEKTEVE  
BASHKIA PATOS

## Rikonstruksioni i Bashkise Patos

# RELACION (KONSTRUKTIV)

**QELLIMI I RELACIONIT:** Evidentimi dhe pershkrimi i ndryshimeve konstruktive ne strukturen mbajtese te godines se Bashkise.


**Hyrje:**Objekti ne shqyrtim eshte godina e cila aktualisht ka funksionin e Bashkise se qytetit te Patosit..Objekti ndodhet ne lagjen “Naftetari”,I pozicionuar ne pjesen fundore te Shetitores “Republika”.Projekti I hartuar ka ne fokus rikonstruksionin e pergjithshem, rikonstruksion I godines dhe sistemimin e ambientit perreth saj.

**Gjendja ekzistuese:**Godina ne fjale ka nje sistem konstruktiv me mure mbajtese,ku ngarkesa e soletave shkarkon fillimisht ne trare dhe me pas keta te fundit ne mure.Muret mbajtese jane te realizuar me tulla te plota dhe trashesia e tyre zvogelohet nga kati perdhe ku kemi mur 48 cm,ne mur 38 ne katin e pare dhe mur 25cm ne katin e dyte dhe te trete.Soletat jane panele te rrafsheta b/a me trashesi 25 cm.

**PROJEKTI:**Ne procesin e rikonstruksionit te godines se qytetit te Patosit,perfshihen nje sere punimesh te cilat jane te listuara ne preventimin e hartuar duke perfshire:


- Punime prishjeje
- Punime shtresash
- Punime b/a
- Punime suvatimi
- Punime dyer/dritare
- Punime elektrike dhe h/sanitare
- Punime te sistemimit te jashtem

**Ndryshimet konstruktive :**Nder proceset e punes te parashikuara,perfshihen nje sere ndryshimesh konstruktive ne strukturen e godines.Duke qene se godina ka nje sistem konstruktiv me mure mbajtese,keto ndryshime konstruktive konsistojne ne nderhyrjet qe parashikohen te realizohen ne muret mbajtese,me qellim hapjen apo mbyllje te dyerve te brendshme,sipas pozicioneve te parashikuara nga arkitekti.Per hapjen e dyerve te reja ne mure mbajtese eshte e nevojshme te behen perforcime me arkitrare dhe fasha anesore b/a ne kornizat e dyerve ,per te perballuar ngarkesen e mureve me tulla.



Duke qene se trashesia e mureve mbajtese,nga kati e perdhe ne katin e trete ndryshon nga 48cm,ne 38 cm deri ne 25cm,lind nevoja te perdoren 3 seksione te ndryshme arkitraresh bazuar ne trashesite e mureve,perkatesisht arkitra me seksion 48x25cm per muret 48 cm,arkitra 38x25 cm per muret 38 cm

dhe arkitra 25x25 cm per muret me trashesi 25 cm.




Mur 48 cm

Mur 38 cm

Mur 25cm

Arkitraret jane te armuar me armature punuese  $\Phi 16$  dhe stafe  $\Phi 8/15\text{cm}$  nderkohe fashat anesore me trashesi 10 cm,jane te armuara me  $\Phi 8$  dhe stafe  $\Phi 6/15\text{ cm}$ .Gjatesia e arkitrareve varion nga hapja e deres por gjithmone duke patur parasysh qe arkitrau del jo me pak se 50cm nga faqa anesore e deres.



Nderkohe ne projekt parashikohen edhe mbyllje e dyerve ekzistuese,mbyllje e cila do te realizohet me mur me tulla te plota.

MBYLLJE DERE ME MUR ME TULLA TE PLOTA (6X12X25)cm

100

Nderkohe nuk kemi nderhyrje ne trare , soleta dhe shkalle.Ndryshmet konstruktive te parashikuara jane te pasqyruara me me detaje ne prerjet arkitektonike qe I jane bere godines.

